

Fletëudhëzues për pacientin

Oksigjen i gaztë mjekësor 100%; Gaz mjekësor, i kompresuar Oxygen

Lexo me kujdes fletëudhëzuesin përpara përdorimit të barit

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund tju duhet ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje, ju lutem drejtohuni tek mjeku ose farmacisti.
- Ky medikament është përshkruar vetëm për ju, dhe nuk duhet tju a jepni personave të tjerë. Kjo mund ti dëmtojë ata, edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore bëhet serioze ose vini re ndonjë efekt anësor jo të shënuar në këtë fletëudhëzues, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj.

- Në këtë fletëpalosje ju do lexoni rreth:
- 1. Çfarë është medikamenti **Oksigjen i gaztë mjekësor** dhe për çfarë përdoret?
- 2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni medikamentin **Oksigjen i gaztë mjekësor**?
- 3. Si duhet ta përdorni medikamentin **Oksigjen i gaztë mjekësor**?
- 4. Efekte të mundshme anësore.
- 5. Si duhet ta ruani medikamentin **Oksigjen i gaztë mjekësor**?
- 6. Informacione të mëtejshme.

1. Çfarë është medikamenti Oksigjen i gaztë mjekësor dhe për çfarë përdoret?

Oksigjen i gaztë mjekësor përmban oksigjen një gaz thelbësor për jetën.

Oksigjen i gaztë mjekësor mund të përdoret për ndihmë respiratore nën presion normal dhe nën presion të lartë.

Oksigjeno-terapia në presion normal (terapia normobarike e oksigjenit) mund të përdoret:

- ☐ nëse përqendrimi i oksigjenit në gjak ose i një organi specifik është shumë i ulët, ose për të parandaluar që përqendrimi i oksigjenit të ulet më shumë sec duhet (hipoksemia).
- ☐ Për pacientët me insuficencë ose frymëmarrje të crregullt të shkaktuar nga përqendrimi i ulët i oksigjenit (hipoksia) si nxitës i frymëmarrjes.
- ☐ si pjesë e rrjedhjes së vazhdueshme në anestezi ose kujdes intensive.

Oksigjeno-terapia në presion të lartë (terapia hiperbarike e oksigjenit) mund të përdoret:

- ☐ Për trajtimin e helmimeve të rënda me monoksid karboni (psh. kur pacienti është pandjenja),
- ☐ Për trajtimin e dhimbjeve të forta të kyceve (sëmundja dekompressive)
- ☐ Për trajtimin e një obstrukcioni në zemër ose në enët e gjakut të shkaktuar nga flluskat e gazit (embolizëm i gazit ose ajrit).
- ☐ Për trajtimin mbështetës në rastet e humbjes së kockës pas radioterapisë (osteoradionekrozë)
- ☐ Për trajtimin mbështetës në rastet e vdekjes së indit si rezultat i një dëmtimi të infektuar me gaz të prodhuar nga bakteret (mionekrozë nga klostridia, gaz gangrene).

Oksigjeno-terapia në presion të lartë duhet të administrohet vetëm nga personel i kualifikuar në mënyrë që të shmanget risku i dëmtimeve që shkaktohen nga luhatjet e presionit.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni medikamentin Oksigjen i gaztë mjekësor?**Mos e përdorni medikamentin Oksigjen i gaztë mjekësor nëse:**

Oksigjeni i gaztë mjekësor në presion të lartë nuk duhet të përdoret në rastet e një mushkërie të shtypur për të cilën ju nuk jeni trajtuar akoma (pneumotoraks i pakuruar). Një mushkëri e shtypur është një akumulim i ajrit ose gazit në kavitetin torakal midis dy membranave pulmonare. Ju lutem të vini në dijeni mjekun tuaj nëse ndonjëherë ju jeni diagnostikuar për mushkëri të shtypur.

Kini kujdesje të veçantë:

Flisni me mjekun, farmacistin ose infermierin tuaj përpara se të përdorni Oksigjen i gaztë mjekësor.

Oksigjeni mund të ketë efekte të dëmshme në përqendrimet të larta. Kjo mund të shkaktojë kolaps të alveolave, që do të bllokojë furnizimin e oksigjenit në gjak. Kjo mund të ndodhë gjatë përdorimit të një përqëndrimi 100% për më shumë se 6 orë, 60 në 70% për më shumë se 24 orë, 40 në 50% për një periudhë tjetër 24 orësh dhe një përqëndrim prej 40% për më shumë se 2 ditë.

☐ Në pacientët me nivele të larta të dioksidit të karbonit në gjak trajtimi me oksigjen mund të cojë në raste ekstreme të humbjes së vetëdijes. Si rrjedhim pacienti duhet të monitorohet me kujdes gjatë trajtimit.

☐ Tek pacientët me probleme të frymëmarrjes që shkaktohen nga përqendrimet të ulta të oksigjenit (hipoksi), oksigjeni mund të përdoret si stimulues i frymëmarrjes por pacientët duhet të monitorohen me kujdes nga mjekët e tyre.

☐ Efektet e dëmshme të oksigjenit mund të rriten në pacientë me tiroide aktive.

☐ Efektet e dëmshme të oksigjenit mund të rriten në pacientë që vuajnë nga një mungesë e vitaminës C, E ose glutacionit.

Gjatë përdorimit të oksigjeno-terapisë në presion të lartë duhet të kontaktoni me mjekun tuaj nëse në historinë tuaj mjekësore keni pasur një prej këtyre gjendjeve shëndetësore:

- ☐ sëmundjen pulmonare obstruktive kronike (COPD)
- ☐ një crregullim i mushkërive i shkakuar si rezultat i humbjes së elasticitetit të indit të mushkërive që shoqërohet me shkurtim serioz të frymëmarrjes (emfizema e mushkërisë).
- ☐ Infeksione të traktit të sipërm respirator.
- ☐ Operacion i vonë i veshit të mesëm.
- ☐ Operacion i çfarëdo lloji periudhe i toraksit.
- ☐ Temperaturë e lartë e pakontrolluar.
- ☐ Frikë nga vendet e mbyllura (klaustrofobi).

Fëmijët

Një kujdes i veçantë kërkohet në trajtimet e fëmijëve të porsalindur dhe të lindur premature. Në këto raste, duhet përdorur përqëndrimi më i ulët efektiv për të minimizuar riskun e dëmtimit të syrit ose efekte të tjera potenciale të pafavorshme.

Administrimi me medikamente të tjera:**Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë, keni marrë së fundmi ose planifikoni të merrni ndonjë mjekim tjetër.**

Administrimi i oksigjenit mund të ulë ose të rrisë efektet e dëshiruara ose të padëshiruara të disa produkteve mjekësore. Konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj për më shumë informacion.

- ☐ amiodaron (një produkt mjekësor që përdoret për trajtimin e rrahjeve të crregullta të zemrës).
- ☐ bleomycin, mitomycin ose aktinomycin (Produkte mjekësore anti-kancerogjen).

Dëmtimet e mëparshme të mushkërive të shkaktuara nga këto produkte medicinale mund të përkeqësohen si pasojë e terapisë me oksigjen, ndoshta me pasoja fatale. Gjendja e dëmtimit pulmonar të shkaktuar nga bleomicina, mitomicina ose aktinomicina mund të jetë fatale.

- ☐ Furadantina dhe antibiotik të ngjashëm.

Produktet mjekësore në vijim mund të rrisin efektet e dëmshme të oksigjenit:

- ☐ adriamycin (Produkt mjekësor anti-kancerogjen).
- ☐ menadion (produkt mjekësor që përdoret për të ulur efektin e anti-koagulanteve),
- ☐ promazinë, kloropromazinë and tioridazinë (produkt mjekësor i përdorur për trajtimin e crregullimeve serioze mendore (psikoza))
- ☐ klorokine (produkt mjekësor i përdorur për trajtimin e malarias dhe disa formave të caktuara të reumatizmes),
- ☐ kortikosteroidet (hormone si kortizoli, hidrokortizoni dhe shumë të tjerë),
- ☐ .medikamente që nxisin pjesë specifike të sistemit nervor (simptomimetiket).

Oksigjeno –terapia mund të ketë dhe efekte të tjera:

- ☐ Më parë trajtonte mushkëritë e dëmtuara ,që shkakttoheshin nga radikalet e lira të oksigjenit(p.sh. në trajtimin e helmimeve me herbicidin parakuat).
- ☐ Veprimi I dëmshëm I oksigjenit mund të rritet prej rrezeve X.

Driving and using machines

Medical oxygen gas has no or negligible influence on the ability to drive and use machines.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive.

Oksigjen i gaztë mjekësor nuk ka ndikim ose ka ndikim të papërfillshëm në aftësinë për të drejtuar dhe për të përdorur makina.

Administrimi i Oksigjen i gaztë mjekësor me ushqim dhe pije.

Mos pini alkool gjatë terapisë me oksigjen sepse alkooli mund t’ju shtyp frymëmarrjen.

Administrimi gjatë shtatzanisë dhe ushqyerjes me gji.

Nëse jeni shtatzënë apo duke ushqyer fëmijën tuaj me gji, mendoni se mund të jeni shtatzënë apo po planifikoni të keni një fëmijë, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj për këshilla para përdorimit të këtij medikamenti.

Gjatë shtatzanisë, përdorimi i oksigjenit në presion normal është i lejuar. Në rastet kur bëhet fjalë për të shpëtuar jetën oksigjeni mund të përdoret gjatë shtatzanisë edhe në përqëndrime të larta dhe presion të lartë. Mjeku juaj do bëjë balancën risk – përfitim të rastit.

Gjithashtu mund ta përdorni oksigjen gjatë ushqyerjes me gji.

Efekti i medikamentit mbi aftësinë për të drejtuar automjetin ose përdorur makineri.

Oksigjen i gaztë mjekësor nuk ndikon në aftësinë tuaj për të drejtuar makinën ose përdorur makineritë.

3. Si ta merrni Oksigjen i gaztë mjekësor?

Përdoreni gjithmonë këtë medikament ashtu sikur është i përshkruar në fletëudhëzuesin e përdorimit ose si mjeku ose farmacisti juaj ju ka këshilluar të bëni, vecanërisht për sa i përket volumit të rrjedhjes dhe kohëzgjatjes së trajtimit. Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni të sigurt.

Mënyra e administrimit:

Oksigjeno – terapia në presion normal

Oksigjen i gaztë mjekësor është një gaz për inhalim që administrohet nëpërmjet ajrit të thithur duke përdorur pajisje të veçanta, të tilla si kateter hundë ose maskë fytyre. Oksigjeni i

administruar largohet nga trupi juaj nëpërmjet ekspirimit dhe përzihet me ajrin e ambjentit.(sistemi i jo- rifrymëmarrjes).

Nëse nuk mund të merrni frymë në mënyrë të pavarur, do të përdoret një pajisje ndihmëse për frymëmarrje artificiale. Gjatë anestezisë përdoren pajisje të posaçme me sisteme “rifrymëmarrje” ose riciklimi në mënyrë që ajri që ekskpirohet të ripërdoret përsëri (sistemi "rifrymëmarrje").

Oksigjeni mund të injektohet dhe direkt në rrjedhën e gjakut duke përdorur pajisjet e quajtuara oksigjenator. Kjo teknike përdoret në rastet kur nevojitet që gjaku të devijohet jashtë trupit , për shembull në rastet e operacioneve të zemrës.

Oksigjeno – terapia në presion të lartë

Oksigjeno – terapia në presion të lartë duhet të administrohet vetëm nga personel i kualifikuar, në mënyrë që të shmangët rreziku i lëndimit për shkak të luhatjeve të forta të presionit.

Në varësi të gjendjes tuaj, terapia e oksigjenit në presion të lartë administrohet në një presion prej 1.4 deri në 3.0 atmosferë, dhe zgjat 45 deri 300 minuta cdo seancë e trajtimit. Terapia ndonjëherë përfshin vetëm një ose dy seanca, por terapite afatgjata mund të kërkojnë deri në 30 seanca ose më shumë, dhe disa seanca ne dite nese eshte e nevojshme.

Oksigjeno – terapia ne presion të lartë aplikohet në një dhomë presioni të projektuar posaçërisht për terapinë e oksigjenit në presion të lartë, ku presioni mund të mbahet deri në tre herë më shumë se presioni atmosferik. Terapia e oksigjenit në presion të lartë mund të aplikohet gjithashtu duke përdorur një maskë të fytyrës të ngushtë me një kapuç që mbulon kokën ose nëpërmjet një tubi trakeal.

Doza e rekomanduar është:

Oksigjeno – terapia në presion normal.

Nëse përqendrimi i oksigjenit të gjakut tuaj ose i një organi të caktuar është shumë i ulët, doktori juaj do t'ju rekomandojë për sa kohë dhe sa herë në ditë duhet të administroni **Oksigjen i gaztë mjekësor**. Qëllimi është të përdoret përqendrimi më të ulët i mundshëm i oksigjenit që është ende efektiv. Megjithatë, përqendrimi aktual i oksigjenit për inhalimin nuk duhet të jetë më pak se 21% dhe mund të rritet deri në 100%.

Në rastet e pamjaftueshmërisë në frymëmarrje ose problemeve të frymëmarrjes dhe varësisë nga përqendrimi i ulët i oksigjenit si stimulues i frymëmarrjes (p.sh. në sëmundjet pulmonare me ngushtim të rrugëve të frymëmarrjes dhe simptoma të zgjatura.

si kollitja, gulçimi kronik dhe prodhimi i mukosit (COPD)) përqendrimi i efektshëm i oksigjenit duhet të mbahet nën 28% dhe ndonjëherë edhe më të ulët se 24%.

Oksigjeno – terapia nw presion tw lartw

Oksigjeno – terapia nw presion tw lartw duhet tw administrohet vetem nga njw personel i kualifikuar.

Përdorimi tek fëmijët

Në foshnjat e porsalindura duhet të përdoret përqendrimi më i ulët efektiv. Në këto raste, duhet të shmangen përqendrime efektive për inhalim të oksigjenit mbi 40% dhe vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme mund të ngrihet përqendrimi në 100%.

Nëse përdorni më shumë Oksigjen të gaztë mjekësor sesa duhet:

Efektet toksike të oksigjenit ndryshojnë sipas presionit të oksigjenit të inhaluar dhe kohëzgjatjes së ekspozimit.

Nëse përdorni më shumë **Oksigjen të gaztë mjekësor** sesa duhet ju mund të përjetoni frymëmarrje të shkurtër (hipoventilim), kollitje dhe dhimbje në gjoks, nauze, marramendje, ankth dhe konfuzion, ngërçe të muskujve, humbje të vetëdijes dhe kriza epileptike. Nëse vini re ndonjë nga këto ankesa fizike, kontaktoni menjëherë mjekun ose infermieren tuaj. Përdorimi i **Oksigjenit të gaztë mjekësor** mund të duhet të reduktohet gradualisht ose mund të duhet dhe të ndalohej në varësi të gjendjes tuaj mjekësore.

Nëse harroni të përdorni Oksigjen të gaztë mjekësor:

Mos përdorni një dozë të dyfishtë për të kompensuar një dozë të harruar, sepse **Oksigjen të gaztë mjekësor** mund të jetë i dëmshëm në përqëndrime të larta.

Nëse ndaloni marrjen e Oksigjen të gaztë mjekësor:

Mos e ndaloni trajtimin, vetëm nëse mjeku juaj ju thotë kështu. Terapia e **Oksigjenit të gaztë Mjekësor** mund të vazhdojë për një kohë relativisht të gjatë. Ju duhet të keshilloheni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni të sigurt.

Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij medikamenti, pyesni mjekun, farmacistin ose infermierin tuaj.

4. Efektet anësore të mundshme

Si të gjithë medikamentet e tjerë edhe **Oksigjen të gaztë mjekësor** mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë i shfaqin ato . Efektet anësore janë grupuar sipas terapisë.

Të gjitha efektet anësore të listuara më poshtë janë me frekuencë të panjohur (dmth frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme).

Oksigjeno-terapia në presion normal mund të rezultojë në:

- ☐ ulje e lehtë e pulsit, dhe në ndalim të zemrës.
- ☐ shkurtim të frymëmarrjes, si rezultat i problemeve në shkëmbimin e gazrave për shkak të obstruksionit të traktit respirator (hipoventilim) ose kolapsit të alveolave (atelektazis)
- ☐ një sëmundje inflamatore të rënde të mushkërive (ARDS - sindromi i distresit akut të frymëmarrjes). Kjo ndodh vetëm pas trajtimit me oksigjen 100% për 24-48 orë.
- ☐ dhimbje krahbarori.

Në pacientët me çrregullime të frymëmarrjes që varen nga përqendrimi i ulët i oksigjenit (hipoksi) si nxites I frymëmarrjes, administrimi i **Oksigjen të gaztë mjekësor** mund të zvogëlojë efektivitetin e frymëmarrjes dhe mund të rezultojë në akumulimin e dioksidit të karbonit dhe acidit të tepërt në trup (acidozë).

Oksigjeno-terapia në presion të lartë mund të rezultojë në:

- ☐ humbje e përkohshme e shikimit,
- ☐ të vjella,
- ☐ marramendje,
- ☐ ankth dhe konfuzion,
- ☐ krampe muskulare,
- ☐ humbje e vetëdijes,
- ☐ kriza epileptike,
- ☐ dëmtim i veshit të mesëm i shkakuar nga luhajtjet e presionit,
- ☐ dëmtim i mushkërive për shkak të luhajtjeve të presionit (barotrauma pulmonare),

- ☐ dhimbje që ndoshta mund të shoqërohet nga inflamacion dhe gjakderdhje në sinuset paranazale të shkaktuara nga luhatjet e presionit,
- ☐ dhimbje të muskujve.

Këto efekte anësore mund të zhduken me kalimin e kohës.

Efekte të tjera anësore tek fëmijët:

Në foshnjat e porsalindura dhe në foshnjat e lindura para kohe, administrimi i **Oksigjenit të gaztë mjekësor** mund të rezultojë në dëmtim të syve, keqformime të mushkërive, gjakderdhje në zemër, tru ose palcë kurrizore dhe në inflamacion të stomakut dhe zorrëve (gastroenterit), me vdekje lokale të qelizave në inde (nekroza) dhe perforacione. Ju duhet të njoftoni mjekun tuaj nëse vini re ndryshimin më të vogël në gjendjen shëndetësore të foshnjës tuaj.

Nëse vini re ndonjë efekt anësor, flisni me mjekun, farmacistin ose infermieren tuaj. Kjo vlen edhe për çdo efekt anësor që nuk është shënuar në këtë fletëpalosje.

5. Si ruhet Oksigjeni i gaztë mjekësor?

- ☐ **Mbajeni medikamentin larg fëmijëve.**
- ☐ Mos e përdorni medikamentin **Oksigjeni i gaztë mjekësor** mbas datës së skandencës të shënuar në paketim. Data eskadences I referohet dites se fundit te atij muaji.
 - ☐ Mos përdorni **Oksigjeni i gaztë mjekësor** nëse vëreni se vula është thyer.
 - ☐ Cilindrat duhet të ruhen në një mjedis të mirë ajrosur.
 - ☐ Të ruhen nën temperaturën 50°C.
 - ☐ Sigurohuni që burime të nxehtësisë ose të zjarrit të mos afrohen pranë cilindrave.
 - ☐ Mos pini duhan pranë cilindrave.
 - ☐ Sigurohuni që prane cilindrave të mos mbahen lëndë të ndezshme.
 - ☐ tregoni kujdes gjatë transportit dhe sigurohuni që cilindrat e gazit të mos hidhen ose të ekspozohen ndaj goditjeve.
 - ☐ Ruajini dhe transportojini cilindrat me valvola të mbyllura dhe, kur duhet transportojini me kapakun mbrojtës dhe mbulesën të vendosur.
 - ☐ Transporti duhet të kryhet në përputhje me rregulloret ndërkombëtare për transportin e lëndëve të rrezikshme.

6. Informacione të mëtejshme

6. Përmbajtja e paketimit dhe informacione të tjera:

Cfarë përmban Oksigjeni i gaztë mjekësor ?

- ☐ Substanca aktive është Oksigjen.

- ☐ Nuk ka lëndë të tjera në përmbajtje të këtij medikamenti.

Pamja e Oksigjenit të gaztë mjekësor dhe përmbajtja e paketimit?

Oksigjenit të gaztë mjekësor është i paketuar në cilindra gazi që janë bërë prej aliazh çeliku, alumini dhe materiale të përbërë pa lidhëse saldimi. Cilindrat e gazit mund të identifikohen në bazë të trupit të tyre të bardhë të cilindrit qafes së bardhë.

Kapaciteti i cilindrave që do të mbushen në presionin 150 bar është 14 l, 40.0 l and 50.0 l.

Mbajtësi i Autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

Emri i kompanisë: Messer Albagaz shpk.

Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës KM. 4.0, Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 48200696

Mob: +355 68 203555780

Fax: +355 48200697

e-mail: info@messer.al

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit më {28/04/2018}.